

## Departamenti i Shkencave Juridike

Veprimtaria kërkimore - shkencore e Departamentit të Shkencave Juridike që ka planifikuar të organizojë për vitin akademik 2018 - 2019 konsiston në:

1. Zhvillimin e Konferencës së 5-të Shkencore Ndërkombëtare "*Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare drejt Standarteve të Bashkimit European*". Kjo konferencë është planifikuar të organizohet në rang Fakulteti, në 14 Dhjetor 2018. Departamenti i Shkencave Juridike, si bashkë-organizator së bashku me

departamentet e tjera të këtij Fakulteti në organizimin e këtij aktiviteti, ka ftuar të gjithë stafin akademik të angazhuar pranë departamentit, për të marrë pjesë në këtë konferencë me punimet e tyre.<sup>1</sup>

2. Në fokus të Departamentit të Shkencave Juridike është gjithashtu nxitja e stafit akademik efektiv dhe stafit akademik me kontrate për të botuar në revista të ndryshme shkencore ndërkombëtare ashtu edhe në revista kombëtare e më konkretisht në revistën e Albanian University "Optime". Gjithashtu pjesëmarrja e stafit akademik në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare do të jetë në fokus të kërkesave të Departamentit.

3. Në vazhden e ndjekjes së traditës në zhvillimin e konferencës studentore, edhe në vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Shkencave Juridike do të organizojë konferencën studentore me temë "*Konsolidimi i Shtetit të së Drejtës në Shqipëri në kuadër të integritetit të vëndit në Bashkimin European*"

Ky aktivitet ka si qëllim aktivizimin e studentëve në aktivitetet ekstrakurrikulare dhe impenjimin e tyre drejt kërkimit shkencor në mënyrë që të nxisë më shumë motivimin e tyre gjatë karrierës Universitare.

Ky aktivitet, fizikisht do të organizohet në një nga sallat në godinën e universitetit, ku zhvillojnë mësimin Programet e Studimit të ofruara në Departamentin e Shkencave Juridike, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes në aktivitet të studentëve të cilët studjojnë në një nga programet e këtij Departamenti. Aktiviteti do të vendosë në qëndër studentët, të cilët me referimet e tyre do të jenë përballë një auditori i cili përbëhet nga kolegët e tyre si

---

<sup>1</sup>

edhe nga pedagogët e Departamentit, në mënyrë që me temat e përzgjedhura prej tyre ata të trajtojnë e të esaurojnë çdo pyetje që do t'u drejtohet nga ky auditor i gjërë.

4. Organizimi i leksioneve të hapura është bërë tashmë traditë për Departamentin e Shkencave Juridike. Edhe këtë vit akademik ashtu si çdo vit tjetër Departamenti do të organizojë leksione të hapura duke ftuar në auditoret tona personalitete të shquara në fushën e drejtësisë. Këto aktivitete ekstra-kurrikulare shihen nga Departamenti i Shkencave Juridike si shumë të rëndësishme për plotësimin e dijeve që vijnë si pasojë e zbatimit në praktikë të kurrikulës.